



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.18/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga anëtarët: Fejzulla Rexhepi kryesues, Ymer Hoxha dhe Adnan Konushevci anëtarë, si dhe me pjesëmarrjen e zyrtarit të lartë ligjor Kudret Hasani, duke vendosur lidhur me ankesën e parashtruar nga subjekti politik Progresivna Demokratska Stranka (PDS) me seli në Graçanic, paraqitur kundër Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ) për shkak të nominimeve të anëtarëve të Këshillave të Vendvotimeve (KVV) në Komunën e Leposaviqit, në seancën e panelit të mbajtur me 29.05.2017, mori këtë:

V E N D I M

Hudhet si e palejuar ankesa Anr.18/2017 i subjektit politik Progresivna Demokratska Stranka (PDS) me seli në Graçanic e datës 28.05.2017.

A r s y e t i m

Parashtruesi i ankesës me datën 28.05.2017 ka paraqitur një ankesë në PZAP me të cilën pretendon se Komisioni Komunal Zgjedhor në komunën e Leposaviqit i ka refuzuar pranimin e listës së subjektit politik PDS për emërimin e anëtarëve të KVV-vë në këtë komunë për kundër ftesës së bërë nga KQZ-ja që në afat të caktuar të dorëzojnë nominimet për anëtarë të KVV për komunat përkatëse. Lidhu me këtë parashtruesi i ankesës thekson se kanë paraqitur propozimet e tyre në mënyrë të rregullt dhe atë në mënyrë elektronike dhe të printuar e ku zyrtari i KKZ-së për komunën e Leposaviqit ka refuzuar pranimin e listës së PDS edhe pse i njëjti do të duhej ta pranonte dhe ta protokollonte. Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se me qëllim që të evitohet skadimi i afatit për dorëzimin e listës me anëtarët e nominuar për KVV, listën me 25 anëtarët e propozuar është detyruar ta reduktoj në 9 anëtarë ashtu siç është kërkuar nga KKZ-ja. e ku me këtë veprim të tillë nga ana e zyrtarit të KKZ-së është shkelur e drejta e PDS-së që tja dorëzoj KQZ-së listën e nominimeve për anëtarë të KVV-ve për komunën e Leposaviqit përkundër qe i plotësojnë kushtet ligjore për një gjë të tillë.

Lidhur me ankesën në fjale PZAP-i e njoftoi KQZ dhe kërkoi përgjigjen në ankesë brenda afatit të përcaktuar. Në përgjigjen në ankesë të KQZ-së me nr. protokolli 746/A- 2017 të datës 29.05.2017 theksohet se KQZ ende nuk ka marrë vendim për miratimin e Këshillave të vendvotimeve për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të vitit 2017

Paneli pasi që shqyrtoi lejueshmërinë e ankesës gjeti se:

Ankesa është e palejuar

Paneli pasi shqyrtoi lëndën konstatoi se ankesa është e palejuar sepse KQZ-ja në kohën e caktuar i fton të gjitha subjektet politike të certifikuara të cilat garojnë në zgjedhjet e përgjithshme që ti dorëzojnë propozimet e tyre në KKZ për personat që dëshirojnë t'i emërojnë anëtarë të KVV-ve të formuara në kuadër të komunave të tyre duke zbatuar rregullat zgjedhore dhe ligjin në fuqi. KQZ deri me tani ende nuk ka marrë vendim lidhur me emërimin e anëtarëve të Këshillave të Vendvotimeve (KVV) për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare 2017.

Andaj, paneli vlerëson se ankesa në këtë fazë është e palejuar për tu parashtuar për faktin se KQZ-ja, ende nuk ka marrë vendim lidhur me emërimin e anëtarëve të Këshillave të Vendvotimeve (KVV) për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare 2017.

Nga arsyet e theksuara më lart e në mbështetje të dispozitës së nenit 118 par.1 të LZP-së, dhe nenit 6 par.4 të Rregullës Nr.02/15 të PZAP-it, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

A nr. 18/2017 më datën 29.05.2017.



Këshillë Juridike:

Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në *Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.*